



Pranuar / Dorezuar / Prenheno / Primito / Received / Delivered	04. 09 2023	3	viti god year
Organ / Pjesia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	5942/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1057/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1021/2023 të datës 24.07.2023 dhe ankesën më numër A.nr. 1057/2023 të datës 04.08.2023 të parashtruar nga ankuesi

Ë bashkuara sipas Vendimit me Nr. Port: 5894/2023 të datës 30.08.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në ankesë me numër A.nr.1057/2023 të datës 04.08.2023, kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike "pezullim nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 04.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1057/2023 e datës 04.08.2023 e parashtruar nga ankuesi.

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.Prot: 1610 i datës 30.06.2023 dhe Vendimi me Nr. Port: 1867 i datës 31.07.2023 i Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.

III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë rishqyrtimin e rastit të ankeusit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2012 në pozitën *Inspektor i Punës* në Inspektoratin e Punës, më datë 29.06.2023 Udhëheqësi për Koordinim Rajonal në Prishtinë, ka inicuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor me arsyetimin se *Njësia Rajonale për Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë në konsultim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë më datë 26.06.2023 kanë intervistuar në cilësinë e të dyshuarit ankuesin me dyshimin për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, dhe i njëjti sipas aktvendimit të Prokurorisë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë është dërguar në mbajtje.*

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më datë 30.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot: 1610 me të cilin ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 24.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5332/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më datë 31.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:1867, me të cilin është pezulluar procedura disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës deri në një vendim tjetër dhe gjatë këtij pezullimi do t'i paguhet paga prej 50% deri në gjashtë muaj.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 04.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5513/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur me ankesat e ankuesit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Inspektorati i Punës. Ndërsa Këshilli, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të ankuesit, është konstatuar se ankesat kanë objektin dhe subjektin e njëjtë, po ashtu pretendimet në ankesë ndërlidhen me raste të njëjta dhe baza juridike për vendosje është e njëjtë, atëherë sipas Vendimit me numër protokollit 5894/2023 të datës 30.08.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur për bashkimin e ankesave të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5332/2023 e datës 24.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot: 1610 të datës 30.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës; Aktgjykimin Pml.nr. 347/2023 i Gjykatës Supreme të Kosovës; Fletës lëshimin e Qendrës së paraburgimit në Prishtinë; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.08.2023; Akt Emërimit e datës 01.01.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.01.2023 dhe 20.01.2022; Kërkesë për hapjen e

procedurës disiplinore e datës 29.06.2023; Ankesën me numër protokolloi 5513/2023 e datës 04.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot: 1867 i datës 31.07.2023 i Komisionit Disiplinor i Inspektoratit të Punës; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 03.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 18.08.2023; Vendimin me numër protokolli 5894/2023 të datës 30.08.2023 për bashkimin e ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje*, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot: 1610 të datës 30.06.2023 dhe Vendimit me Nr. Prot: 1867 të datës 31.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, pretendon se këto vendime janë kontradiktore ngase si mund të vendosur për një rast identik nga dy vendime; Nëse i referohemi dispozitave të nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë pezullimi sipas detyrës zyrtar mund të bëhet nëse gjykata vendos si masë parandaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës; Masa e pezullimit të marrëdhënies së punës me 50% të pagës për gjashtë muaj është në kundërshtim me legjislacionin përkatës për zyrtarët publikë; Me janë shkelur të drejtat për informim të drejtë në procedurë.

Në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankuesit, por duke u bazuar në provat materiale, Kolegji i Këshillit me qëllim të vendosjes së kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se fillimisht Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës sipas Vendimin me Nr.Prot: 1610 të datës 30.06.2023 ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit me 50% të pagesë deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar, ndërsa me Vendimin me Nr.Prot:1867 të datës 31.07.2023 Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës nuk ka bërë shfuqizimin e vendimit paraprak por vetëm ka vendosur që të pezullohet procedura disiplinore ndaj ankuesit dhe njëkohësisht ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës deri në një vendim tjetër dhe gjatë këtij pezullimi do t'i paguhet paga prej 50% deri në gjashtë muaj, ndërsa me rastin e mos shfuqizimit të vendimit paraprak ky komision ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të kundërshtuar me ankesë, e që kanë të bëjnë me pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit Kolegji i Këshilli, ju referuar dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me pezullimin e marrëdhënies së nëpunësit civil, konkretisht sipas nenit 55 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: "1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil", po ashtu sipas nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: "1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji", ndërsa neni 48 paragrafi 5 i të njëjtit ligj përcakton se: "Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar", andaj

duke iu referuar akteve normative të lartcekura, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit arrihet në përfundimin se Komisioni Disiplinor ka diskrecion që të pezullojë nga puna nëpunësin civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore, mirëpo vetëm për periudhën kohore sa zhvillohet procedura disiplinore, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar, nga rrjedh se kuptimi i kësaj norme ndërlidhet me përfundimin e procedurës disiplinore dhe vendimmarrjen brenda afateve të përcaktuara kohore siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë: *“Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore”*.

Andaj nisur nga dispozitat ligjore të analizuara si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor në Inspektoratin e Punës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot: 1867 të datës 31.07.2023, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, ngase përveçse e ka pezulluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, ka bërë edhe pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit deri në një vendim tjetër dhe gjatë këtij pezullimi do t'i paguhet paga prej 50% deri në gjashtë muaj, kur dihet fakti se në kuptim të nenit 58 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *“4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj”*, nga rrjedh se sipas kësaj logjike vendimmarrëse ankuesi duhet të kompensohet plotësisht gjatë periudhës kohore përderisa Komisioni Disiplinor e ka pezulluar komplet procedurën disiplinore pa shqiptim të masës disiplinore, dhe kjo krijonë situatë të pasigurisë juridike, çështje të cilën normat e ligjit material e kanë rregulluar krejt ndryshe, gjegjësisht Komisioni Disiplinor me rastin e pezullimit të procedurës disiplinore duke e mbajtur ankuesin edhe të pezulluar nga punë njëkohësisht, ka dal përtej mandatit dhe kompetencave të tyre ligjore, ngase në kuptim të nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi”*, sipas kësaj norme vetëm Gjykatës i është njohur ligjërisht kjo e drejtë apo kompetencë që ndaj nëpunësit civil mund të vendos masë parandaluese penale me qëllim të pezullimit të ushtrimit të detyrës zyrtare, deri në vendosjen meritore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se çështja e institutit të pezullimit të marrëdhënies së punës e rregulluar me nenin 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka përcaktuar nëntë (9) raste kur nëpunësit civil mund të pezullohen nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare, dhe nga të gjitha këto vetëm për një (1) rast i është rezervuar e drejta diskrecionale Komisionit Disiplinor që të pezullojë nëpunësin civil sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht në rastet kur ndaj të njëjtit hapet apo inicohet procedurë disiplinore nga Komisioni Disiplinor, mirëpo vetëm deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar që zgjidh çështjen juridike brenda afateve kohore të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se Vendimi me Nr.Prot: 1867 i datës 31.07.2023 i Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës nuk është vendim përfundimtar në procedurë

administrative, ngase përmes të njëjtit nuk është zgjedhur çështja juridike e iniciuara sipas kërkesës së datës 29.06.2023 për iniciimin e procedurës disiplinore, gjegjësisht me vendimin e njëjtë nuk është konfirmuar nëse ankuesi ka kryer shkelje disiplinore apo jo.

Po ashtu, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës me rastin e vendosjes sipas Vendimit me Nr. Prot: 1867 të datës 31.07.2023, ka theksuar se sipas Aktgjykimi Pml.nr. 347/2023 i Gjykatës Supreme të Kosovës, ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale me numër PPRK.Nr. 155/2023, ndërsa Kolegji i Këshillit referuar këtij aktgjykimi i njëjti është vendosur vetëm për masën e paraburgimit me të cilin i njëjti është liruar nga masa e paraburgimit duke u bërë ndryshimi i Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me numër PPRKR.nr.155/2023 dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda me numër PN.I.nr.698/2023, ndërsa sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk mund të konkludohet që ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale, ngase në bazë të provave të lëndës ankuesi ka dëshmuar se përmes Certifikatës mbi Dënimet Penale të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 22.07.2023 dhe 03.08.2023 vërtetohet se ankuesi nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, kështu që sipas Kolegjit të Këshilli, Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës para vendosjes së kësaj çështje është dashur që të vërtetohet faktin nëse ndaj ankuesit është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale nga organet e drejtësisë, me qëllim që të vihet deri tek një përfundim i drejtë dhe i saktë në mënyrë që të vie në shprehje pezullimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit dhe të aplikohen dispozitat e nenin 85 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Prot: 1610 të datës 30.06.2023 dhe Vendimit me Nr. Prot: 1867 të datës 31.07.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material si dhe kompetencat e përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe si i tillë është i palosshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, meqë këto vendime përmbajnë të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast tek Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj rastin e ankuesit lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe vërejtje të dhëna sipas këtij vendimi, dhe po ashtu gjatë vendimmarrjes të marr të gjitha informatat e nevojshme procedurale ndërlidhur me këtë rast dhe të aplikoj drejtë dispozitat materiale në mënyrë që ankuesit mos t'i cenohen të drejtat e garantuar me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1057/2023, datë 04.09.2023

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.